



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Fier, më

Njoftim Publik

**(Shprehje interesi për shfrytëzim hapësire publike në lidhje me bizneset që ushtrojnë
aktivitet ekonomiko-tregtar në territorin e Bashkisë Fier).**

Fokusi i njoftimit publik

Shprehje interesi për shfrytëzim hapësire publike nga subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomiko- tregtar, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 107/2014 “ Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i ndryshuar, Ligiin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “ Për miratimin e rregullores së zhvillimit i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”, VKB nr 13351/2 dt 03.12.2025 “ Mbi Strukturën, nivelin e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026” ,njofton të gjithë subjektet e interesuar të cilët ushtrojnë aktivitet ekonomiko-tregtar, brenda territorit të Bashkisë Fier dhe janë të interesuar ta kryejnë këtë shërbim në hapësirat publike të përcaktuara nga Bashkia Fier duke plotësuar dokumentacionin si më poshtë:

- 1.Kërkesë për shprehje interesi;
- 2.Dokumentacioni që vërteton pronësinë apo të drejtat të drejtat e ligjshme përfshirë kontratë qiraje të objektit ku ushtrohet aktiviteti ekonomiko-tregtar.
- 3.Dokumentacioni ligjor i regjistrimit të subjektit bazuar në Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar.
- 4.Ekstrakti i nxjerrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- 5.Leje ushtrimi aktiviteti.
- 6.Foto të ambjentit ku ushtrohet aktiviteti.
- 7.Sipërfaqja e shprehur në m2 për zënie të hapësirës publike(planvendosje).
- 8.Vërtetim për shlyerje detyrimesh si biznes si dhe vërtetim shlyerje detyrimesh për taksën e pasurisë ku ushtrohet ky aktivitet.

Dokumentacioni së bashku me kërkesën për zënie të hapësirës publike duhet të dorëzohen pranë zyrës One Stop Shop pranë Bashkisë Fier deri në datën 31.01.2026.